

KPMG Albania Sh.p.k. - Kosovo Branch
Sulejman Vokshi, No. 14
Pristina
Kosovo

Telephone +381 38 246 771
Telefax +381 38 246 772
E-mail al-kosovo@kpmg.com
Internet www.kpmg.al

RAPORTI I AUDITIMIT

PËR PASQYRAT VJETORE FINANCIARE TË KOMUNËS SË
DRAGASHIT PËR VITIN E PËRFUNDUAR ME 31 DHJETOR 2011

Prishtinë, Qershor 2012

TABELA E PËRMBAJTJES

I. Përmbledhje e përgjithshme.....	3
II. Hyrje	5
III. Opinioni i auditimit.....	7
IV. Gjendja e rekomandimeve të viteve të kaluara	10
V. Rezultati financiar në krahasim me Buxhetin e Aprovuar.....	11
VI. Pasqyrat financiare- Pajtueshmëria me kornizen e raportimin dhe kualiteti i informacioneve financiare	12
VII. Menaxhimi financiar.....	12
VII.1 Të hyrat (duke përfshirë ato vetanake)	12
VII.2 Shpenzimet.....	14
VII.3 Transferet dhe Subvencionet.....	15
VII.4 Pasurit dhe Borxhet.....	15
VII.5 Raportimi aktual dhe afati kohor në procesin e buxhetit të përgjithshëm	17
VIII.Kontrolli mbi menaxhimin.....	17
VIII.1 Sistemet e Kontrollit të Brendshëm	17
VIII.2 Komiteti i auditimit.....	18
IX. Një konkluzion i Përgjithshëm mbi Menaxhmentin e Komunës së Dragashit	19
Shtojca I. Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit të aplikuar nga KPMG në Auditimin Vjetor 2011.....	20
Shtojca 2: Rekomandimet e vitit paraprak.....	22
Shtojca 3 Komentet e menaxhmentit të Komunes së Dragashit dhe përgjigjet e KPMG-se	24

I. Përmbledhje e përgjithshme

KPMG-ja ne emer te Zyres se Auditori Gjeneral te Kosoves, ka kryer auditimin e pasqyrave vjetore financiare (PVF) të Komunës së Dragashit ("Komuna"), për Zyren e Auditorit te Përgjithshem te Kosoves, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2011.

Auditimi ynë është kryer në pajtim me Standartet ndërkombëtare të auditimit, të hartuara nga Organizata Ndërkombëtare e Udhëzimeve Supreme të Auditimit (ONUSA) dhe ka përfshirë testimet dhe procedurat që ne menduam se ishin të nevojshme për të dhënë një opinion lidhur me pasqyrat financiare.

Më poshtë ju lutem gjeni një ekstrakt të marrë nga opinionit i auditimit në faqën 7-10 të këtij dokumenti:

"Sipas mendimit tonë, përveç mungesës së informacionit të përshkruara në paragrafet e bazës së opinionit të kualifikuar, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë në të gjitha aspektet materiale të hyrat dhe pagesat për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2011 në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNSKP) për *"Raportimin financiar në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme"* dhe me Rregulla financiare nr 07/2011 *Mbi Raportimin Vjetor të Organizatave buxhetore"*

Mesazhet kryesore ndaj Kryetarit, që rezultuan në kualifikim të opinionit janë:

1. Informatat krahasuese për vitet 2009 dhe 2010 nuk janë të plota dhe të sakta. Në veçanti, çështjet në vijim kanë munguar ose janë shpalosur në mënyrë jo të drejtë në pasqyrat financiare:
 - Shënimi 6 "Pranimet e tjera" nuk përputhet me nenin 12 *"Pasqyra e Pranimit dhe Pagesave në Para të Gatshme"*.
 - Shënimi 15 "Të hyrat vetanake" nuk përputhet me nenin 13 *"Raporti i Ekzekutimit të Buxhetit"* për vitet 2009 dhe 2010.
 - Shënimi 16 "Grantet dhe ndihmat" nuk përputhet me nenin 13 *"Raporti i Ekzekutimit të Buxhetit"*.
 - Shënimi 30 *"Përmbledhja e pasurive kapitale jo financiare mbi EUR 1,000 në posedim nga organizata buxhetore"* nuk është plotësuar për vitet 2009 dhe 2010, Komuna ka shpalosur vetem paisjet dhe kategorite e tjera të pasurive nuk janë shpalosur.
 - Shënimi 35 *"Balanca e të hyrave vetanake të pashfrytëzuara"* nuk përputhet me shënimin 15 *"Të hyrat vetanake"* për vitet 2009 dhe 2010.

Kontrollat e Brendshme

Auditimi ynë ka identifikuar dobësi në disa fusha të menaxhimit financiar. Këto dobësi janë të përshkruara më në detaje brenda këtij raport.

Konkluzioni ynë është se sistemet e brendshme të Komunës nuk janë të dizajnuara dhe zbatuara si duhet për të eliminuar dobësitë evidente. Kjo duhet të adresohet për të përmirësuar efektshmërinë e Komunës.

Në mënyrë që të përmirësohet funksionimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollet e brendshme, ne i rekomandojmë Komunes për tu siguruar se:

- Një listë gjithëpërfshirëse lidhur me pronat, objektet dhe paisjet është në posedim dhe i mirëmbajtur;
- Një sistem i automatizuar i faturimit për të gjitha llojet e taksave është në posedim dhe i mirëmbajtur;
- Te behen barazimet e të ardhurave në mes të zyrtarit të të hyrave vetanake dhe departamenteve operacionale;
- Te marren masa për rritjen e mbledhjes së të ardhurave nga taksat e ndryshme; dhe
- Ligji 04/L-042 lidhur me "Ligji për Prokurimin Publik në Kosovë" të dyja të aplikueshme gjatë periudhave të ndryshme të vitit 2011, te ndiqen.

Menaxhimentit të Komunës i është dhënë mundësia për të komentuar mbi gjetjet e prezantuara në këtë raport. Menaxhimenti ka rënë dakord të bëjë të gjitha përpjekjet për të adresuar te gjitha rekomandimet tona.

Referojuni Shtojces 3 për përmbledhjen e rekomandimeve dhe përgjigjet.

II. Hyrje

Ky auditim ka të bëjë me pasqyrat vjetore financiare të Komunës së Dragashit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2011.

Është përgjegjësi e Komunës të përgatisë pasqyrat vjetore financiare sipas kërkesave të Rregulles financiare 07/2011 dhe në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNSKP) për “Raportimin financiar në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme”.

KPMG, në emër të Zyrës e Auditorit të Përgjithshëm është përgjegjëse për kryerjen e auditimit vjetor të pasqyrave financiare të Komunës, në dhe për vitin e përfunduar me 31 Dhjetor 2011.

Auditimi përkufizohet si një verifikim i kontabilitetit financiar, duke përfshirë ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave të tjera financiare si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

“Kemi kryer vlerësimin preliminar të Komunës. Gjatë këtij vlerësimi kemi rishikuar Pasqyrat Financiare të Komunes për periudhën e mbyllur me 30 shtator 2011 dhe kemi vlerësuar pajtueshmërinë e tyre me kërkesat e rregullit financiar 06/2011, kemi vlerësuar adresimin e rekomandimeve të dhëna në vitin paraprak për Komunen nga auditori i mëparshëm dhe kemi shikuar kualitetin e menaxhmentit financiar nënjet plotësimi të pyetsorit shëndetsor. Duke u bazuar në këtë, kemi këshilluar menaxhmentin. Rekomandimet tona kanë të bëjnë me përmirësimet që duhet të bëhen në lidhje me pasqyrat financiare që të jenë në përputhje me Rregullen Financiare nr. 07/2011 dhe Standartet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) për Raportimin Financiar të Kontabilitetit në baza Keshi.”

Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësiave tona për auditimin e Komunës, ne kemi ndërmarrë aktivitetet si në vijim:

- Kemi rishikuar pasqyrat vjetore financiare të Komunës në raport me buxhetin e miratuar në dhe për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2011;
- Kemi përcaktuar nëse pasqyrat vjetore financiare të Komunës janë përgatitur në pajtim me SNKSP “Raportimi Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme” dhe Rregullen Financiare nr. 07/2011;
- Kemi përcaktuar nivelet e materialitetit, si prag për lehtësimin e përcaktimit të llojit të opinionit që duhet dhënë mbi pasqyrat financiare
- Kemi zbatuar një kombinim të mostrimit sipas gjykimit dhe sipas rastit, në përzgjedhjen e transaksioneve për testim;

- Kemi kryer testime substanciale mbi transaksionet financiare; dhe
- Jemi mbështetur në një kombinim të intervistave, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve financiare;

Në këtë raport ne përmbledhim gjetjet gjatë auditimit të këtij viti dhe japim një opinion formal mbi Pasqyrat Vjetore Financiare për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2011.

Lidhur me opinionin tonë të auditimit për pasqyrat vjetore financiare të Komunës, standartet ndërkombëtare të auditimit përcaktojnë kriteret specifike të cilat rregullojnë llojin e opinionit që mund të jepet.

Këto janë paraqitur më gjerësisht në Shtojcën 1 që përfshin një ekstrakt nga ISSAI 4000.

III. Opinioni i auditimit

Per Komunen e Dragashit,

Prishtinë, 25 qershor 2012

Ne kemi qenë të angazhuar në auditimin e pasqyrave financiare të Dragash ("Komuna"), që përbëhen nga pasqyra e pranimet dhe pagesave të kesh-it për fund vitin 31 Dhjetor 2011, një krahasim të shumave të buxhetuara dhe aktuale, dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontable dhe shënimeve të tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e Menaxhimit për Pasqyrat Financiare

Menaxhimenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik Bazuar në Paranë e Gatshme ("SNKSP") – Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të Bazuar në Paranë e Gatshme dhe me Rregullen Financiare Nr. 07/2011 Raportimi Vjetor i Organizatave Buxhetore. Kjo përgjegjësi përfshin: hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e një kontrolli të brendshëm të përshtatshëm për përgatitjen e sinqertë të pasqyrave financiare pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

Përgjegjësia e Audituesve

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Puna jonë është kryer në përputhje me Standartet ndërkombëtare të publikuara nga Organizata Ndërkombëtare e Udhëzimeve Supreme të Auditimit (ONUSA). Këto standarte kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të arritur deri të një siguri e arsyeshme nëse pasqyrat financiare janë pa gabime materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të grumbulluar dëshmi auditimi për shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi jonë, duke përfshirë vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në bërjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, ne e marrim në konsideratë kontrollin e brendshëm të entitetit në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare me qëllim hartimin e procedurave të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo me qëllimin për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin e përshtatshmërisë së parimeve kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të bëra nga menaxhimenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të përgjithshëm të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se evidenca që ne kemi marrë është e përshtatshme dhe e mjaftueshme për të dhënë një bazë për opinion të kualifikuar.

Baza për një Opinion të Kualifikuar

1. Informatat krahasuese për vitet 2009 dhe 2010 nuk janë të plota dhe të sakta. Në veçanti, çështja në vijim ka munguar ose është shpalosur në mënyrë jo të drejtë në pasqyrat financiare:
 - Shënimi 6 "Pranimet e tjera" nuk perputhet me Nenin e 12 "Pasqyra e Pranimet dhe

Pagesave në Para të Gatshme”;

- Shënimi 15 “Të hyrat vetanake” nuk përputhet me Nenin 13 “Raporti i ekzekutimit të buxhetit” për vitet 2009 dhe 2010;
- Shënimi 16 “Grantet dhe ndihmat” nuk përputhet me Nenin 13 “Raporti i ekzekutimit të buxhetit”;
- Shënimi 30 “Përmbledhja e pasurive jo financiare kapitale mbi EUR 1,000 në posedim nga organizata buxhetore” nuk është i plotë për vitet 2009 dhe 2010 sepse Komuna ka shpalosur vetëm paisjet dhe nuk ka shpalosur kategoritë e tjera të pasurive; dhe
- Shënimi 35 “Bilanci i të hyrave vetanake të pa shpenzuara” nuk përputhet me shënimin 15 “Të hyrat vetanake” për vitet 2009 dhe 2010.

Opinion i kualifikuar

Sipas opinionit tonë, përveç për mangësi në informacionet e përshkruara në paragrafet për bazat për kualifikim të opinionit, pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë dhe të sigurtë në të gjitha aspektet materiale pagesat dhe pranimet për vitin 31 Dhjetor 2011 në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik Bazuar në Paranë e Gatshme (‘SNKSP’) *Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të Bazuar në Paranë e Gatshme* dhe me Rregullen financiare Nr. 07/2011 *Raportimi Vjetor i Organizatave Buxhetore*.

Çështje për tu theksuar

Pa modifikuar opinionin tonë, ne tërheqim vëmendjen për çështjen në vijim:

- Megjithatë Komuna ka përgatitur dhe ka shpalosur një listë gjithëpërfshirëse të pasurive të patundshme në Shënimin 30, për disa pasuri, mund të ketë pasiguri në lidhje me të drejtat e pronësisë mes Komunës dhe disa agjencive Qeveritare të Kosovës, dhe mungesë të dokumenteve mbështetëse për pronësi.
- Për shkak të mungesës të dokumenteve shtesë, për matjen e një pjese të konsiderueshme të pronës, tokës dhe paisjeve, të shpalosura në Shënimin 30, Komuna ka kërkuar të masë këto artikuj të tillë me vlerë të drejtë duke u bazuar në vlerësimin e kryer nga komiteti i brendshëm i formuar. Komiteti nuk është i përbërë nga vlerësues profesionalë dhe vlerat e raportuara në pasqyrat financiare nuk janë të mbështetura nga ndonjë raport vlerësimi.

Çështje të tjera

Pasqyrat financiare të Organizatës për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2010 janë audituar nga një auditor tjetër, data e raportimit të të cilit është 8 prill 2011 dhe shprehte opinion të kualifikuar për këto pasqyrat financiare. Kualifikimet janë të lidhura me: shpalosje të pa kompletuara të pagesave nga palët e treta, pasurive jo financiare dhe të arkëtueshmeve.

Rishikimi i përputhshmërisë

Përveç auditimit të pasqyrave financiare, është planifikuar dhe kryer një rishikim i përputhshmërisë për të shprehur një konkluzion me siguri të kufizuar nëse në të gjithë aspektet materiale, aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e reflektuara në pasqyrat financiare janë në përputhje me autoritetet që i qeverisin ato. Natyra, koha dhe masa e punës për përputhshmërinë ishin të kufizuara krahasuar me atë të hartuar për të shprehur një opinion me siguri të arsyeshme për pasqyrat financiare.

Përgjegjësia e Audituesve

Përgjegjësia jonë është të shprehim një konkluzion bazuar në rishikimin tonë. Puna jonë është kryer në përputhje me ISSAI 4200 Udhëzime mbi Auditimin e Përputhshmërisë Lidhur me Auditimin e Pasqyrave Financiare. Këto parime kërkojnë që ne të zbatojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe kryejmë rishikimin për të arritur një siguri të kufizuar nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e reflektuara në pasqyrat financiare janë në përputhje, në të gjithë aspektet materiale me autoritetet që i qeverisin ato.

Një rishikim është i kufizuar kryesisht në procedura analitike dhe intervista, dhe për këtë jep më pak siguri se një auditim. Ne nuk kemi kryer një auditim, dhe për këtë arsye, ne shprehim konkluzionin tonë në formën e një sigurie të kufizuar, e cila është konsistente me punën e kufizuar që ne kemi kryer për këtë rishikim përputhshmërie.

Ne besojmë se evidenca që ne kemi marrë është e përshtatshme dhe e mjaftueshme për të dhënë një bazë për konkluzionet tona.

Konkluzion për Përputhshmërinë

Bazuar në punën tonë të përshkruar në këtë raport, aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e reflektuara në pasqyrat financiare që kemi parë gjatë rishikimit, janë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me autoritetet që i qeverisin ato.

Çështje të tjera

Ne tërheqim vëmendjen për sa më poshtë:

1. Burimi kryesor e i besueshëm i informacionit për përgatitjen e pasqyrave financiare është Free Balance. Për më tepër, pasi që Komuna nuk ka përdorur Free Balance për të regjistruar pagesat nga palët e treta dhe faturat e papaguara, atëherë ky nuk mund të përdoret vetëm për të prodhuar pasqyra të plota financiare.
2. Pasiqë Komuna nuk ka implementuar një sistem faturimi automatik dhe gjithëpërfshirës, ekziston një pasiguri lidhur me plotësinë e të arkëtueshmeve dhe të hyrave dhe do të ndikojë në të hyrat që Komuna mund të fitojë, dhe në aftësinë për të përgatitur një buxhet të besueshëm dhe të saktë, për të raportuar një raport të saktë arkëtueshmërie, dhe për të monitoruar arkëtimet e të hyrave vetanake në baza kohore.
3. Ne kemi identifikuar disa mospërputhje me Ligjin Nr. 03/L-241 dhe 04/L-042 'Ligji i Prokurimit Publik' të dyjat të aplikueshme në periudha të ndryshme të vitit 2011. Mospërputhje të tilla janë të lidhura me procedurat e kërkuara të cilat Komuna nuk i ka kryer dhe dokumentuar.
4. Edhe pse Kryetari dhe Zyrtari Kryesor Financiar ka nënshkruar Deklaratën lidhur me prezantimin e pasqyrave financiare, Komuna nuk ka paraqitur një draft final të pasqyrave financiare në gjuhën serbe deri më 31 janar 2012.
5. Megjithatë Komuna mund të jetë e përfshirë në disa raste të vogla ligjore dhe dalje e parasë se gatshme mund të jetë e nevojshme në të ardhmen e afërt, Komuna nuk ka një proces formal e cila do të siguronte informacione të plota, të sakta dhe të besueshme për të regjistruar provizionet dhe detyrimet kontigjente.

KPMG Albania Shpk Kosovo Branch

KPMG Albania Sh.p.k. – Dega Kosovë

Sulejman Vokshi, Nr.14.

Prishtinë

Kosovë

IV. Gjendja e rekomandimeve të viteve të kaluara

Komuna e Dragashit ishte audituar nga një auditor tjetër në vitin e përfunduar me 31 dhejtor 2010. Auditorët e vitit paraprak kishin bërë pesë rekomandime kryesore, prej tyre vetëm një ishte zgjidhur pjesërisht gjatë vitit 2011 e cila ka të bëjë me pronën, objektet dhe paisjet dhe 4 te tjerat mbeten per tu adresuar, si në vijim:

- Pasqyrat financiare duhet të përgaditen në përputhje me rregulat financiare dhe SNKSP;
- Të mbahet një sistem faturimi automatik për të gjitha llojet e taksave dhe duhet të merren masa për ngritjen e nivelit të mbledhjes së taksave;
- Resource të tjera (vleresues të pavarur dhe të certifikuar) duhet të përfshihen në regjistrimin dhe vlerësimin e pronave të Komunes; dhe
- Përmirësimet duhet të implementohen në fushat e shpenzimeve dhe pagave dhe mëditjeve; dhe
- Komiteti i Auditimit duhet të krijojë politika dhe procedura në mënyrë që të sigurojë standard të larta të qeverisjes.

V. Rezultati financiar në krahasim me Buxhetin e Aprovuar

Analiza e Rezultatit në Pasqyrat Financiare kundrejt Buxhetit të Aprovuar tregon:

Tabela 1: Përshkrimi i buxhetit dhe shpenzimeve

Përshkrimi	Buxheti Fillestar	Buxheti Rishikuar	Buxheti Final	2010 Realizimi	2009 Realizimi
Të hyrat vetanake	368	-	392	392	397
Donacionet e vendit	-	-	246	181	-
Donacionet e jashtme	-	-	-	-	-
I. Gjithsej të hyrat dhe transferi i donacioneve	368	-	638	573	397
Rrogat dhe pagat	3,170	-	3,178	3,143	2,451
Mallra dhe shërbime	321	-	477	413	368
Shpenzimet komunale	96	-	115	115	95
Subvencionet dhe transferet	36	-	36	36	32
Investimet Kapitale	1,959	-	2,163	1,978	1,619
Rezervat	-	-	-	-	-
II. Gjithsej shpenzimet	5,582	-	5,969	5,685	4,565
Ndryshimi I-II	-	-	117	-	-

Shumat e buxhetuara janë nxjerrë nga pjesët në vijim në kuadër të Pasqyrave Financiare, për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2011: Neni 13 Raporti i ekzekutimit të buxhetit.

Konkluzioni

Të ardhurat totale aktuale dhe transferet e donacioneve ishin më të ulëta se buxheti final për 65 mijë euro për shkak se donacionet ishin më të ulëta për 65 mijë euro.

Të dalurat totale aktuale dhe transferet e donacioneve ishin më të ulëta se buxheti final për 284 mijë euro për shkak se pagat dhe mëditjet ishin qenë më të ulëta për 35mijë euro, mallrat dhe shërbimet më të ulëta për 65 mijë euro dhe shpenzimet kapitale më të ulëta për 184 mijë euro.

Buxheti fillestar ishte më i ulët për 270 mijë euro nga buxheti përfundimtar për shkaqet si më poshte: të hyrat vetanake dhe të hyrat vetanake të bartura fillimisht ishin parashikuar me të ulëta për 141 mijë euro dhe granti nga donatorët për 246 euro. Të gjitha ndryshimet në buxhetin fillestar janë miratuar siç duhet nga Kryetari dhe Kuvendi Komunal. Këto ndryshime janë mbështetur edhe nga vendimi kuvendit dhe të mandatuar nga korniza ligjore ligji 03/L-048.

Buxheti i pashpenzuar i Komunes në 2011 është 4.8%.

VI. Pasqyrat financiare- Pajtueshmëria me kornizen e raportimin dhe kualiteti i informacioneve financiare

Të Gjeturat

Kërkesat e LMFP nr. 03/L-048 dhe Rregullit financiar nr. 07/2011:

- Komuna ka përgatitur pasqyrat financiare në pajtueshmëri me Rregullen financiare nr. 07/2011.
- Pasqyrat Financiare janë nënshkruar nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar nga subjektit të audituar;
- Pasqyrat Financiare janë nënshkruar brenda kornizës kohore me 31 janar 2012 dhe janë dorëzuar në Ministrinë e Financave (MF);
- Pasqyrat Financiare janë pranuar vetëm në gjuhën shqipe; dhe
- Komuna ka përgatitur dhe ka dorëzuar raporte të rregullta tremujore tek MF gjatë vitit 2011.

Rekomandimi 1

Komuna duhet gjithashtu të përgadisë pasqyrat financiare edhe në gjuhën serbe.

VII. Menaxhimi financiar

VII.1 Të hyrat (duke përfshirë ato vetanake)

Të Gjeturat

Gjatë testimit tonë të të hyrave ne kemi vërejtur:

- *Sistemi i faturimit.* Një sistem automatik i faturimit ekziston vetëm për tatimin në pronë. Për kategoritë e tjera të të ardhurave nuk aplikohet ndonjë sistem i faturimit. Në vend të kësaj regjistrohen vetëm paratë e pranuar në kesh nga këto burime.
- *Mbledhja e të hyrave.* Me përjashtim të tatimit mbi pronë, menaxhmenti i Komunës nuk mban libër të veçant apo listë të të gjithë debitorëve nga tatime të ndryshme. Pa regjistrimin e duhur, të detajuar dhe të saktë të të gjithë debitorëve, Komuna nuk mund të përgatis një buxhet të besueshëm dhe të saktë, të raportoj një tregues mbledhshmërie të saktë apo të ndjekin mbledhjen e të hyrave vetanake në kohën e duhur.
- *Barazimi i të hyrave.* Me përjashtim të nënpunësit e licencës të biznesit, asnjë departament tjetër nuk performon ndonja barazim formal të të hyrave të mbledhura me departamentin e kontabilitetit gjatë vitit 2011.

- *Dobësitë e sistemit të automatizuar të faturimit.* Faturimi i tatimit në pronë është i centralizuar dhe Komuna nuk mund të shqyrtojë dhe monitorojë mbledhjet e të hyrave sepse bëhet automatikisht nga sistemi.
- *Regjistrimi i të hyrave në SIMFK.* Shumat e marra nga të hyrat vetanake në bankë, në datat si në vijim: 5,6,10,11,12,13 dhe 14 janar 2011, nuk janë regjistruar në SIMFK deri më 17 janar 2011 dhe janë regjistruar vetëm në totale për secilën ditë. Kjo ka ndodhur sepse nënpunësi i të hyrave vetanake nuk ka marrë kodin autorizues të sistemit deri më 17 Janar 2011.

Rekomandimi 2

Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet se Komuna do të ndërmarrë hapa për te përmirësuar sistemin e kontabilitetit dhe të faturimit në mënyre që të sigurojë kontroll të sigurt, eficient dhe efektive në faturim dhe të hyra. Përmirësimi i procedurave të lidhura me këto sisteme do të mundësonte menaxhmentit të monitorojë dhe menaxhojë rreziqet e mëdha dhe të sigurojë që vendimet në lidhje me buxhetimin, planifikimin dhe mbledhjen e të hyrave janë bartur siç duhet. Ne i rekomandojmë komunës të konsiderojë pikat si në vijim:

- Implementimin e një sistemi të faturimit që përfshin detaje të përditësuara për pagesit, adresën e tyre të tanishme, historinë dhe normën e mbledhjes së të hyrave nga këta pages. Qasje në informacion të tillë duhet të kenë vetëm një numër të limituar personash dhe të autorizuar nga menaxhmenti.
- Të vendosë dhe të kontrollojë nga qendra tarifat dhe normat e taksave në sistem, në mënyre që të llogarisë dhe gjenerojë automatikisht faturat. Ky gjenerim i faturave gjithashtu duhet të autorizohet dhe të rishikohet.
- Të ekzistojë një lidhje automatike në mes të sistemit të faturimit dhe sistemit të kontabilitetit në mënyre që informacioni të procesohet automatikisht në librin kryesor të kontabilitetit.
- Të lidhen automatikisht zyra e faturimit me operacionet dhe të bëhen barazime të rregullta në mes tyre, për rastet ku faturimi direkt lidhet me shërbimet nga zyra operacionale. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në rastet kur ekzekutohet një numër i madh i transaksionesh.
- Të regjistroj të hyrat vetanake në SIMFK në kohën e duhur dhe me detajet e kërkuara.

VII.2 Shpenzimet

2.1 Blerjet përmes prokurimet

Të Gjeturat

Gjatë inspektimit tone të dokumenteve për mostrën tone të dosjeve të prokurimit ne kemi vërejtur disa mospërputhshmëri me procedurat siç kërkohet nga Ligji për Prokurim Publik PL 04/L042. Këto mos përputhje janë përshkruar më poshtë:

- Deklarata e përcaktimit dhe nevojave të fondeve në disponim mungon ne tre prokurime: 300/10/25/121ne lidhje me prokurimin per blerjen e furnizimeve per zyre, 600/10/26/221 ne lidhje me prokurimin per mirmbajtjen e veturave dhe 110/10/24/121 lidhur me prokurimin per nafte per ngrohje.
- Në prokurimet në vazhdim, çmimi i vlerësuar në deklaratën e përcakimit dhe nevojave të fondeve në disponim mungon: 621/11/32/121 lidhur me prokurimin per furnizimi me dru per ngrohje, 621/11/46/521 ne lidhje me prokurimin per ndertimin e ujsjellesit dhe 621/11/44/521 lidhur me prokurimin per asfaltimin e rruges.
- Prokurimi me nr. 621/11/32/121 lidhur me prokurimin per furnizim me dru per nrohje, Zyrtari i pranimit te mallrave dhe sherbimeve ka nënshkruar edhe si Zyrtar Autorizues.

Rekomandimi 3

Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet se Komuna do të ndërmarrë hapa të mëtijshëm për përmirësimin e kontrolleve mbi shpenzimet dhe pagesat, dhe të jetë në pajtueshmëri të plotë me legjislacionin dhe kërkesat e rregulloreve lokale.

2.2 Blerjet tjera

Të Gjeturat

Nuk ka gjetje për të raportuar.

2.3 Shpërblimet (Pagat dhe Mëditjet)

Të Gjeturat

- Nga testet e performuara ne kemi vërejtur se e gjithë dosja e personelit me inicialet H.H. mungonte, kjo ka ndodhur sepse punonjesi ka tërhequr dokumentat për të kompletuar procedurën për pension.
- Trembëdhjetë nga shtatëmbëdhjetë rastet e CPO-ve të pagave nuk ishin të nënshkruara nga Zyrtari i Departamentit Administrativ.

- Për punëtorin me initiale B.H., nënshkrimi i punëtorit mungonte në kontrate dhe koeficienti i pagës, sipas kontratës, nuk përputhet me atë në sistemin e pagave.

Rekomandimi 4

Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet se Komuna do të ndërmarrë hapa të mëtijshëm për përmirësimin e kontrolleve dhe të jetë në pajtueshmëri të plotë me legjislacionin dhe kërkesat e rregulloreve lokale në lidhje me personelin.

VII.3 Transferet dhe Subvencionet

Të Gjeturat

Nuk ka gjetje për të raportuar.

VII.4 Pasurit dhe Borxhet

4.1 Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj

Të Gjeturat

Nuk ka gjetje për të raportuar

4.2 Trajtimi i të arkëtueshmeve

Të Gjeturat

Komuna nuk ka një proces të identifikimit, evidentimit apo ndjekjes të faturave të lëshuara për tatimet.

Duke u bazuar në vëzhgimet tona të dokumenteve, shumë nga të arkëtueshmet e shpalosura në pasqyrat financiare, lidhen me vitet parapake. Komuna nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për të mbledhur këto shuma dhe nuk ka bërë asnjë analizë të vjetërsisë.

Rekomandimi 5

Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurojë që një proces të dizajnohet dhe themelohet i cili do të sigurojë që të arkëtueshmet të regjistrohen pas lëshimit të secilës fature dhe që shumat që u ka kaluar afati i pagesës të ndiqen rregullisht.

4.3 Pasuritë kapitale dhe jo kapitale

Të Gjeturat

Megjithëse Komuna ka përgatitur dhe shpalosur një listë të plotë të pasurisë së pronës në shënimin 30, për disa pasuri, mund të ketë paqartësi në lidhje me të drejtat e pronësise mes Komunës dhe disa Agjensive Qeveritare të Kosovës, dhe mungesë të dokumentacioneve mbështetëse.

Për shkak të mungesës së dokumentacioneve mbështetëse për matjen e një pjese të konsiderueshme të pronës, objekteve dhe paisjeve të shpalosura në shënimin 30, Komuna ka matur këto mjete me vlerë të drejtë duke u bazuar në vlersimin e bërë nga një komitet i brendshëm. Komiteti nuk është i përbërë nga eksperte të vlerësimit dhe shumat e raportuara në pasqyrat financiare nuk janë të mbështetura nga raporte të vlerësimit.

Rekomandimi 6

Ne i rekomandojmë Kryetarin të përfshijë burime shtesë në regjistrimin dhe vlerësimin e pasurive të Komunës. Përfshirja e vlerësuesve të pavarur dhe të certifikuar rekomandohet sepse është praktika më e mirë në këto raste. Megjithatë, Komuna duhet të marre në konsideratë një analizë të kostos vs. benefiteve përpara se të angazhojë vlerësues të jashtëm.

4.4 Borxhet

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2011 ishte në vlerë prej EUR 24 mijë. Këto obligime barten për pagesë në vitin fiskal 2012.

Të Gjeturat

Sipas Ligjit me nr. LPFMM 03/L-048, Nenit 39.1, organizata buxhetore është përgjegjëse për sigurimin e pagesës brenda dhridhjetë (30) dite kalendarike pas marrjes së faturës, për secilën faturë të vlefshme dhe kërkesës për mallra dhe shërbime të furnizuara dhe/apo punëve të përfunduara për organizatën e buxhetore përkatëse. Ne kemi vërejtur se shumë nga faturave të prezantuara të papaguara u ka kaluar afati prej tridhjetë (30) ditë në fund të vitit.

Rekomandimi 7

Ne i rekomandojmë Kryetarin të Komunës të sigurojë se komuna do të ndërmarrë hapa të mëtijshme për të përmirësuar procedurat e kontrollit mbi shpenzimet dhe pagesat, dhe të jetë plotësisht në përputhje me kërkesat e ligjeve dhe rregulloret lokale. Duhet të bëhen të gjitha përpjekjet për të bërë pagesat brenda tridhjetë (30) diteve.

VII.5 Raportimi aktual dhe afati kohor në procesin e buxhetit të përgjithshëm

Përmbushja e detyrimeve aktuale të raportimit të jashtëm si dhe procesi i buxhetimit:

- Kërkesat buxhetore u realizuan në kohën e duhur;
- Raportet tremujore, duke përfshirë pasqyrat financiar për nëntë muaj, janë dorëzuar në kohën e duhur në MF;
- Draft plani i prokurimit po ashtu është dorëzuar në MF me kohë;
- Plan i veprimit për implementimin e rekomandimeve është përfshirë në pasqyrat financiare vjetore të Komunës.

Të Gjeturat

Nuk ka gjetje të tjera për të raportuar.

VIII. Kontrolli mbi menaxhimin

VIII.1 Sistemet e Kontrollit të Brendshëm

Të Gjeturat

Burimi kryesor i besueshëm i informacionit për përgatitjen e pasqyrave financiare është Free Balance. Megjithatë, pasi Free Balance nuk përdoret në regjistrimin e pagesave nga palët e treta, apo faturat e papaguara, nuk mund të përdoret vetëm për të prodhuar pasqyrave financiare gjithë përfshirëse për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2011.

Pikat në vijim nuk janë shpalosur apo janë shpalosur në mënyrë të gabuar, në pasqyrat financiare për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2011:

1. Informatat komperative për vitet 2009 dhe 2010 nuk janë të kompletuara dhe të sakta. Në veçanti, pjesët në vijim mungojnë apo janë shpalosur gabim në pasqyrat financiare.
 - Shënimi 16, “Grantet dhe ndihmat” nuk barazohet me nenin 13 “Buxheti dhe raporti ekzekutiv”.
 - Shënimi 30, “Përmbledhja e pasurive kapitale jo financiare mbi EUR 1,000 në posedim nga organizata buxhetore” nuk është e kompletuar për vitet 2009 dhe 2010 sepse Komuna ka shpalosur vetëm paisjet dhe asnjë kategori tjetër e pasurive nuk është shpalosur.
 - Shënimi 6, “Pranimet tjera” nuk barazohen me nenin 12 “Pasqyra e pranimeve dhe pagesave”.

- Shënimi 15, “Të hyrat vetanake” nuk barazohet me nenin 13 “Raporti i buxhetit ekzekutues” për vitet 2009 dhe 2010.
- Shënimi 35, “Balanca e të hyrave vetanake të pashpenzuara” nuk barazohet me shënimin 15 “Të hyrat vetanake” për vitet 2009 dhe 2010.

Rekomandimi 8

Ne rekomandojmë Kryetarit të siguroj që përgatitja e pasqyrave financiare të Komunës duhet të përfshijë procedura dhe mjete të cilat janë të dizajnuara të sigurojnë që informatat e kërkuara janë regjistruar, procesuar, përmbledhur dhe raportuar në mënyrë të saktë në pasqyrat financiare.

VIII.2 Komiteti i auditimit

Te gjeturat

Edhe pse Komuna ka formuar komitetin e auditimit, ai nuk ka bërë ndonjë punë gjatë vitit 2011.

Rekomandimi 9

Ne rekomandojmë që Komuna duhet të përgadisë politika dhe procedura të pershtatshme dhe të siguroj standard të lartë të qeverisjes. Komiteti i Auditimit duhet të rishikojë statusin aktual dhe të propozojë veprime për përmirësime si më poshtë:

- Kontabiliteti dhe proceset e raportimit financiar të Komunës;
- Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm të implementuara nga Menaxhimi;
- Proceset e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm;
- Përputhshmëria, raportimi dhe strukturat e kontrollit në gjithë Komunën të tilla që sigurojnë përputhje me kërkesat financiare, rregullatore dhe ligjore; dhe
- Plani i auditimit të brendshëm dhe ndjekja e gjetjeve të auditimit të brendshëm.

IX. Një konkluzion i Përgjithshëm mbi Menaxhmentin e Komunës së Dragashit

Konkluzionet e përgjithshme

Siç u diskutua në këtë raport, përmirësime duhet të bëhen në fushat e të ardhurave, të prokurimit, shpërblimet, trajtimin e arkëtueshme, pagesën e detyrimeve brenda afatit të kërkuar, matja e pasurive kapitale dhe jo kapitale, sistemet e kontrollit të brendshëm, Auditim të Brendshëm dhe Komitetit të Auditimit

Rekomandimet e përgjithshme

- Pasqyrat financiare duhet të pergaditen ne perputhje me Rregullat Financiare aktuale dhe SNKSP.
- Të bëhet implementimi i një sistemi të faturimit automatik për të gjitha llojet e të hyrave, të bëhet barazimi i të dhënave të mbajtura në kontabilitet me ato të zyrtarit të të hyrave apo departamenteve operationale dhe të ndërmerren masa për rritjen e arkëtimit të të hyrave nga taksat e ndryshme; dhe
- Duhet të behen te gjitha perpjekjet qe te permiresohet procedurat per shpenzimet
- Duhet të behen perpjekje te paguhen faturat e papaguara brenda vitit.
- Komiteti i auditimit duhet të kryej detyrat dhe pergjegjesite e tij dhe duhet te krijoje politika dhe procedura per te siguruar standarde te larta te qeverisjes.

Shtojca I. Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit të aplikuar nga KPMG në Auditimin Vjetor 2011

(e shkëputur nga ISSAI 400)

9. Një opinion i auditimit normalisht është një format standard, ndërlidhur me pasqyrat financiare si tërësi, duke shmangur nevojën për të caktuar gjatësinë e saj por duke bartur sipas natyrës së saj një kuptim të përgjithshëm tek lexuesit sipas kuptimit të saj. Natyra e këtyre fjalëve do të ndikohet nga korniza ligjore të auditimit, por përbërja e opinionit duhet të tregoj qartë a është i pakualifikuar apo i kualifikuar, apo nëse është i kualifikuar në disa çështje të caktuara apo është opinion i kundërt (paragrafi 14), apo është mohim i opinionit (paragrafi 15).

10. Një opinion i pakualifikuar jepet kur auditori është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale që:

- (a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke shfrytëzuar baza dhe politika të pranuar të kontabilitetit të cilat janë zbatuar në mënyrë konsistente (të qëndrueshme);
- (b) pasqyrat janë në pajtim me kërkesat statusore dhe rregulloret relevante;
- (c) pamja e paraqitur në pasqyrat financiare janë në përputhje me njohuritë e auditorit në lidhje me entitetin e audituar;
- (d) është një shpalosje adekuate e të gjitha çështjeve materiale relevante për pasqyrat financiare.

11. Theksi i çështjeve. Në disa rrethana auditori mundet të konsideroj se lexuesi nuk do të kuptoj në mënyrë të duhur pasqyrat financiare nëse vëmendja është përqendruar në çështje të pazakonshme apo të rëndësishme. Si një rregull e përgjithshme, auditori kur jep një opinion të pakualifikuar kjo nuk i referohet ndonjë aspekti specifik të pasqyrave financiare në opinionin e tij në rast se kjo mund të interpretohet gabimisht si opinion i kualifikuar. Me qëllim të shmangies së kësaj përshtypjeje, referencat që janë menduar si; nënvizim i çështjes; gjinden në paragrafët e ndara nga opinionin. Sidoqoftë, auditori nuk duhet të përdor nënvizimin e çështjes për të përmirësuar mungesën e shpalosjeve të duhura në pasqyrat financiare apo si alternativ, zëvendësim për kualifikim të opinionit.

12. Auditori mund të mos jetë në gjendje të shpreh një opinion jo të kualifikuar kur ekziston një nga ato rrethana dhe në gjykimin e auditorëve, afektin e tyre është ose mund të jetë materiale për pasqyrat financiare:

- (a) Ka pasur limitime në fushëveprimin e auditimit;
- (b) Auditori konsideron që pasqyrat janë jo komplete apo çorientues apo ekziston një ndarje e pajustificuar nga Standartet e pranueshme të kontabilitetit; apo
- (c) Ekzistojnë paqartësi që ndikojnë në pasqyrat financiare.

13. Opinioni i Kualifikuar. Aty ku auditori nuk pajtohet apo nuk është i sigurt në lidhje me një ose me tepër artikuj të veçantë në pasqyrat financiare e që janë materiale por jo edhe fundamentale në kuptimin e pasqyrave, duhet të jepet një opinion i kualifikuar. Formulimi i opinionit normalisht tregon një rezultat të kënaqshëm ndaj subjektit të audituar, sa i përket një pasqyre të qartë dhe koncize, të çështjeve të mospajtimit apo edhe të paqartësive që ngrisin opinion e kualifikuar.

I ndihmon përdoruesit e pasqyrave nëse efekti financiar i paqartësisë apo edhe i mosmarrëveshjeve është përcaktuar nga ana e Auditorit edhe pse kjo nuk është gjithmonë praktike apo relevante.

14. Opinioni i Kundërt. Aty ku Auditori nuk ka mundësi të jap një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, për shkak të mosmarrëveshjeve që është aq thelbësore ngase e minon pozitën e prezantuar në vazhdim që opinionin që kualifikohet në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, atëherë jepet opinion i Kundërt. Formulimi i një opinionin të tillë e bën të qartë se pasqyrat financiare nuk janë prezantuar në mënyrë të drejtë, duke specifikuar qartë dhe në mënyrë koncize të gjitha çështjet e mosmarrëveshjeve. Përsëri, është një ndihmesë që efekti financiar mbi pasqyrat financiare përcaktohet aty ku duhet dhe është praktik.

15. Mohimi i Opinionit. Aty ku Auditori nuk mund të jep opinion në lidhje me pasqyrat financiare, të marrë si tërësi për shkak të paqartësisë apo restriksionit të fushëveprimit që është thelbësor që një opinion që është i kualifikuar në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, jepet opinion i kundërt. Formulimi i një opinionin të tillë e bën të qartë që një opinion nuk mund të jepet, duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha çështjet e paqarta.

16. Është bërë zakon që ISA të ofrojnë një raport të detajuar për të plotësuar opinion në rrethana në të cilat është e pamundur të jepet një opinion jo i kualifikuar.

Shtojca 2: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimi i dhene	Rekomandimi i implementuar plotesisht	Pjeserisht i adresuar	I pa adresuar
VI. Pasqyrat Financiare - Pajtueshmëria me kornizën e raportimit dhe cilësinë e informacionit	Përgatitja e pasqyrave financiare duhet të përfshijë procedurat dhe mjetet për të siguruar që informacioni i kërkuar është i regjistruar, përpunuar, përmbledhur dhe raportuar në mënyrë të drejtë në pasqyrat financiare.			Pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2011 nuk janë paraqitur në gjuhën serbe.
VII.4.3 Aktivitet dhe Borxhet	Të mbahet një regjistër të plotë të pronës, impianteve dhe pajisjeve.		Zyrtari për regjistrimin e ndërtesave, makinerive e pajisjeve është trajnuar dhe regjistrimi i pronës ka filluar.	
VII.1 Te ardhurat	Të përmirësohet faturimi dhe sistemi i kontabilitetit			Nuk është adresuar
VII 2.2 Blerjet përmes Prokurimit	Kryetari duhet të sigurojnë që Komuna ndërmerr hapa të mëtijshme për të përmirësuar kontrollin mbi shpenzimet dhe pagesat dhe në mënyrë rigoroze të jete në përputhje me ligjet dhe kërkesat rregullatore lokale.			Nuk është adresuar
VIII. Kontrolli i Menagjmentit	Komuna duhet të krijojë politika dhe procedura të duhura për të siguruar një standard të lartë të qeverisjes korporative. Komiteti i Auditimit duhet të rishikojë statusin aktual dhe të propozojë veprimet për përmirësim në vijim:			Vendimi për të formuar komitetin e auditimit është marrë. Komiteti i auditimit nuk ka bërë ndonjë punë ende.

Komponenti i Auditimit	Rekomandimi i dhene	Rekomandimi i implementuar plotesisht	Pjeserisht i adresuar	I pa adresuar
